



VENDIM
Nr. 23 Datë 23.03.2010

PËR
LICENSIMIN E SHOQËRISË “HEC-i BISHNICA 1,2” SH.P.K

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 gërma “a”, nenit 9 dhe 13 pika 1, gërma “a” dhe nenit 15 të Ligjit nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “a”, neni 5 pika 1 germa “a” dhe nenet 13 dhe 14 pika 1 të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 23.03.2010, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Hec Bishnica 1, 2” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi plotëson përgjithësisht kërkesat e ERE-s lidhur me liçensimet në sektorin e energjisë elektrike të:

- **Formatit të aplikimit (neni 9, pika 1)**
- **Dokumentacionit juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2)**
- **Dokumentacionit finaciari dhe fiskal (neni 9, pika 3)**
- **Dokumentacionit teknik (neni 9, pika 4)**

Mungesa e Dokumentacionit që ka të bëjë me:

Miratimin e OST sh.a ose OSSH sh.a për lidhjen e centraleve me sistemin elektroenergetik është shoqëruar nga miratimi për pikën e lidhjes nga Drejtoria Rajonale e OST sh.a Elbasan dhe është në pritje të përgjigjes nga Drejtoria Qëndrore për ta paraqitur më pas në ERE.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,



Vendosi:

1. Të licensojë shoqërinë “HEC-I BISHNICA 1,2” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec – Bishnica 2, me kusht qe te paraqese dokumentin e miratimit te pikes se lidhjes me sistemin elektroenergjetik para fillimit te operimit te HEC-it.
2. “HEC-i BISHNICA 1,2” shpk të fillojë ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Bishnica 2 sipas afatit te përcaktuar në marrëveshjen e koncesionit.
3. Afati i vlefshmerise se licenses te jete 30 vjet.
4. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE-s
Bujar Nepravishta

